



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 421/5 prot.

Tiranë, më 19.10.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 701, datë 25.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 5.10.2023, është njoftuar vendimi nr. 701, datë 25.9.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin në rivlerësim, znj. Jurida Bajraktari, me detyrë Ndhimëse ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.

Së bashku me vendimin përfundimtar, si pjesë e akteve në dosje, Komisioni ka përcjellë pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë dhe *vendimin e ndërmjetëm* nr. 5 të Komisionit, nr. 496 akti, datë 20.7.2022, me anë të cilit ka vendosur: [...] *pezullimin nga detyra të znj. Jurida Bajraktari, për një periudhë njëvjeçare me detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës* [...].

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, si përfaqësues i interesit publik, neni F i aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin përfundimtar të marrë nga Komisioni për subjektet e rivlerësimit, brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afati ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 701, datë 25.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Znj. Jurida Bajraktari është subjekt rivlerësimi për shkak të pozicionit të saj si Ndhmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, referuar pikës 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ndaj i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si *Komisioni*) ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si *KLGG*), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI¹, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të: “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Jurida Bajraktari*”, ka referuar: [...] (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*(ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e saj;* (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë ndër vite;* (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë;* (iv) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave [...].*

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të Raportit² mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ka referuar: [...] *Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës [...].*

2.3 KLGJ, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti, gjatë periudhës objekt rivlerësimi dhe pesë dosjeve të përzgjedhura me short, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin³ për analizimin e aftësisë profesionale.

3. Në përfundim, Komisioni, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

3.1 Për vlerësimin e pasurisë⁴. [...] *Pavarësisht disa gjetjeve lidhur me mosdeklarime apo pasaktësi në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, nuk ka rrethana të tilla që mund të cenojnë kriterin e vlerësimit të pasurisë apo procesin në tërësi të rivlerësimit të subjektit [...]* dhe në përfundim [...] *trupit gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, ka një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

3.2 Për kontrollin e figurës⁵. [...] *Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

¹ Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/***/***/ prot., datë ***/***/2018.

² Shkresa e DSIK-së me nr. ***/***/***/ prot., datë ***/***/2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-s nr. ***/***/, datë ***/***/2021.

³ Shkresa e KLGJ-së me nr. ***/***/***/ prot., datë ***/***/2022.

⁴ Referohuni faqes 11 të vendimit të Komisionit.

⁵ Referohuni faqes 11 të vendimit të Komisionit.

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale⁶. [...] Bazuar në rezultatet e arritura, të miratuara nga Këshilli Pedagogjik, si dhe Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. 31, datë 18.7.2023, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, është vlerësuar “mirë” në testimin përfundimtar, duke tejkaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Për sa rezultoi më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a”, nenit 59, pika 1, dhe të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur: [...] *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, Ndhimëse ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë* [...].

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

6. Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

7. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet përfundimtare të dhëna nga Komisioni, *duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij, në të cilën janë arsyetuar në mënyrë të plotë konkluzionet dhe qëndrimi i Komisionit në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit*, është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

8. Sa më sipër, Komisioneri Publik, *nga shqyrtimi i vendimit përfundimtar me nr. 701, datë 25.9.2023*, çmon se ai përmban shkaqe ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 701/2023 të Komisionit.

⁶ Referohuni faqes 14 të vendimit të Komisionit.

II.A Vlerësimi lidhur me aspekte të zbatimit të ligjit dhe ato procedurale të vendimit

9. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në çështjen objekt shqyrtimi, shtrohen paraprakisht aspekte të zbatimit të ligjit, sa vijon:

9.1 Komisioneri Publik, në analizë të akteve në dosje, rezultateve të hetimit, si dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁷, si dhe jurisprudencën e Kolegjit, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni dhe çmon se, në vlerësimin tërësor të procedurave, të lidhura në rastin konkret me kontrollin e aftësisë profesionale dhe pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke u gjendur po ashtu në kushtet që mangësitë e evidentuara lidhur me aftësitë profesionale janë të tilla që nuk mund të plotësohen, as nga programi i trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, përkundër sa ka disponuar me vendim të ndërmjetëm Komisioni.

9.2 Jurisprudenca e Kolegjit lidhur me shkakun ligjor të “*cenimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë*” ka vendosur standardin se është plotësisht e përshtatshme që institucionet e rivlerësimit të japin masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi vetë ligji nr. 84/2016, në nenin 61, pika 5 e tij, autorizon në mënyrë specifike një masë të tillë disiplinore, në rastet kur subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe objektive tërësinë e sjelljeve të subjektit të rivlerësimit dhe mbrojtjen e interesit publik në këtë proces.

9.2.1 Për sa i përket matjes së cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, jurisprudenca e Kolegjit ka vendosur standardin që institucionet e sistemit të drejtësisë duhet të gjenerojnë besim të vazhdueshëm të publiku, duke vepruar në mënyrë efektive dhe të drejtë, në përputhje me legjislacionin dhe duke e demonstruar këtë të qytetarët. Ka një sërë sjelljesh nëpërmjet të cilave subjektet e rivlerësimit minojnë integritetin e institucioneve të drejtësisë dhe cenojnë besimin e publikut në sistemin tonë të drejtësisë, përmes korrupsionit, marrëdhënieve të rreme, shkeljes së betimit si nëpunës publik, veprimet në situatën e konfliktit të interesit, pa aftësisë në punën profesionale, vendosjes së interesave privatë përpara interesit publik etj.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

10. Problematikat e evidentuara, referuar gjendjes së akteve, në procesin e rivlerësimit të znj. Bajraktari, të cilat paraqiten para juridiksionit kontrollues të Kolegjit lidhen me: (i) sjellje të shfaqura në deklarin në funksion të kontrollit të pasurisë; (ii) mangësi të evidentuara nga organi përkatës ndihmës i vlerësimit të aftësive profesionale (KLGJ); (iii) sjellje të dala nga aktet e administruara nga Komisioni, për procedurën e emërimit në detyrën e Ndihmëses ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit, sikundër do të trajtohen në vijim:

⁷ Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, në paragrafin 54 të tij, ndër të tjera citohet se, në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë se: [...] Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias)]...

III/A. Gjetje në kontrollin pasuror

11. Në *D-Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vijon: Në rubrikën “*Deklarim i pasurive*”, ka deklaruar pasurinë e luajtshme *autoveturë e markës Citroen C3 Exclusive*, me vlerë 2.211.325 lekë, pjesa takuese 50% dhe burim i krijimit të ardhurat nga biznesi i bashkëshortit.

12. Në rubrikën “*Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike*” ka deklaruar të ardhura nga punësimi pranë shoqërive të sigurimit *** sh.a. dhe *** sh.a. në ***, Kosovë dhe shoqërive private *** *** & *** dhe *** sh.p.k., në Shqipëri. Të ardhura nga punësimi në ente publike janë deklaruar në IEPV nr. ***, Burgu ***, Tiranë, për një periudhë 1-mujore, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, për periudhën ***.7.2007 - ***.9.2009, dhe Gjykata Administrative e Apelit, për periudhën ***.4.2016 - ***.12.2016.

12.1 Në rubrikën “*Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*” ka deklaruar kredi standarde në shumën 1.000.000 lekë, me kredidhënës Banka ***, me shumë detyrimi financiar të pashlyer 1.100.000 lekë.

13. Në *D-Vetting*, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, ka deklaruar si vijon:

13.1 Në rubrikën “*Deklarim i pasurive*” ka deklaruar pasurinë e luajtshme *autoveturë e markës Citroen C3 Exclusive*, me vlerë 2.211.325 lekë, pjesa takuese 50% dhe burim i krijimit të ardhurat nga aktiviteti tregtar prej vitit 2001 - 2007, në Prishtinë, Kosovë.

13.2 Në rubrikën “*Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike*” ka deklaruar të ardhura në shumën 130.800 euro nga aktiviteti në sektorin privat në Prishtinë, Kosovë, për periudhën 2001-2007; Të ardhura në shumën 3.216.919 lekë nga paga në kompaninë e sigurimeve *** sh.a., në periudhën 19.2.2008 - 31.3.2014.

13.3 Në rubrikën “*Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*” ka deklaruar kredi bankare në shumën 700.000 lekë, me kredidhënës Banka ***, me shumë detyrimi financiar të pashlyer 72.815 lekë.

13.4 Nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ rezultuan akte që dëshmojnë marrëdhënie financiare të padeklaruara në *D-Vetting*, dhe më konkretisht: (i) qenien palë në Kontratën *për kreditim me kusht dhe hipotekimi*, me nr. *** rep., dhe nr.***/** kol., datë ***.12.2016, me palë kreditore *** Bank sh.a. dhe palë debitore znj. *** ***, person fizik, palë debitor/hipotekues z. *** *** dhe palë debitore/solidar z. *** ***, personi i lidhur, kredia është në shumën 35.000.000 lekë; (ii) Kontratë kredie me të njëjtat palë me nr. ***, datë ***.12.2016, bashkëlidhur së cilës në Aneksin nr. 2, shuma 2.600.000 lekë ka si destinacion *blerje shtëpie* dhe (iii) Kontratë kredie me të njëjtat palë me nr. ***, datë ***.12.2016, bashkëlidhur së cilës në Aneksin nr. 2, shuma 1.970.000 lekë ka si destinacion *aktive fikse të përziera*⁸; (ii) Detyrimin nga kontrata *e qirasë* me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë ***.9.2016, me palë qiradhënëse *** *** dhe palë qiramarrëse personin e lidhur, z. *** ***, me objekt *pasuri 57m² sipërfaqe e brendshme*, me lulishte, me vendndodhje në Tiranë, me afat 2-vjeçar dhe qira mujore 900 euro.

⁸ Sipas akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, detyrimet ndaj *** Bank janë mbyllur nëpërmjet kontratës së kredisë me Bankën *** Albania sh.a., me nr.*** rep. dhe nr. *** kol., të datës ***.8.2021, për shumën 60.000.000 lekë.

14. Komisioni, me aktin “Rezultatet e hetimit”,⁹ i ka pasqyruar rrethanat e verifikuara sa më sipër në formën e konstatimeve, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e datës 14.7.2022, ka dhënë shpjegimet e saj për kredinë, si dhe për kontratën e qirasë, duke paraqitur deklarata noteriale të znj. *** *** në cilësinë e kredimarrësit dhe z. *** *** në cilësinë e palës qiradhënëse.

15. Komisioni, në përfundim të kontrollit dhe vlerësimit të kriterit të pasurisë, pasi konstaton se kanë rezultuar disa [...] gjetje lidhur me mosdeklarime apo pasaktësi në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, arrin në përfundimin se: nuk ka rrethana të tilla që mund të cenojnë kriterin e vlerësimit të pasurisë apo procesin në tërësi të rivlerësimit të subjektit [...].

16. Komisioneri Publik vëren se, në rastin konkret, këto rrethana të konstatuara nga Komisioni, për shkak të nevojës së vlerësimit në harmoni me gjetjet dhe përfundimet vijuese në këtë ankim, duhen mbajtur në konsideratë për vlerësimin tërësor të procedurës së rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që, edhe në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit nuk parashtrroi shkaqe të tilla ligjore, që të sillnin si pasojë shuarjen e detyrimit të deklaratimit në momentin e plotësimit të D-Vetting, duke u gjetur kështu, subjekti i rivlerësimit, në kushtet e deklaratimit të pasaktë.

III/B. Gjetje në vlerësimin profesional

17. Komisioni, në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale është bazuar në tri burime: (i) Raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga KLGJ-ja; (ii) Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 165 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; (iii) Dokumentacionin e mbledhur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

18. Raporti i KLGJ-së, “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Jurida Bajraktari, për periudhën ***.4.2016 - 14.4.2019”, është përgatitur në bazë të nenit 43, “Procedura për vlerësimin e aftësisë profesionale”, të ligjit nr. 84/2016. Raporti është i hollësishëm dhe i arsyetuar, duke u bazuar në tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe 5 dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

19. Referuar aktit “Rezultatet e hetimit” janë pasqyruar të plota konstatimet e Raportit të KLGJ-së të datës 27.5.2022, si organi përkatës ndihmës i vlerësimit të aftësive profesionale, nga ku, ndër të tjera, rezulton si vijon:

19.1 Formulari i vetëdeklarimit nuk është plotësuar sipas formës standarde, pasi nuk është i plotë dhe i panëshkruar në çdo fletë të tij. Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit të deklaruara në rubrikën “B”, është: (a) Jurist në shoqërinë tregtare “****” sh.p.k., për periudhën gusht 2010-dhjetor 2011; (b) Periudhë papunësie për arsye shëndetësore për periudhën janar 2012 deri në mars 2016, dhe për (c) Periudhën ***.4.2016 deri aktualisht ushtron detyrën e Ndhmëses ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.

⁹ Nga analiza financiare e kryer për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur me të për periudhën e deklaratimit, Komisionit i ka rezultuar pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme në shumën -489.071 lekë, referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni në faqen 10 të Rezultateve të hetimit.

19.2 Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit janë: (i) Një relacion, (ii) një vendim për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe (iii) një draft përfundimtar, dokumente këto që i përkasin vitit 2016.

19.3 Referuar konstatimeve të Raportit të KLGJ-së, që janë pjesë e *Rezultateve të hetimit* të Komisionit, nga shqyrtimi i dokumentit të parë: (i) *Relacion për çështjen administrative me nr.*** regj., datë ***.11.2014*, është konstatuar se: [...] *përfaqëson më tepër një përshkrim të vendimmarrjes së Gjykatës së Shkallës së Parë dhe parashtrim të pretendimeve të ngritura në ankim nga pala paditëse... Nuk ka mendim/sugjerim të vetë Ndhmësit ligjor për zgjidhjen e çështjes, por vetëm referim te shkaqet e ngritura në ankim [...].*

19.4 Nga shqyrtimi i dokumentit të dytë, (ii) *Relacion për çështjen administrative me nr.***/***/*** regj., datë ***.11.2014*, është konstatuar se relacioni paraqitet në formën e vendimit për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, nga shqyrtimi i të cilit rezulton se: [...] *përfaqëson më tepër një përshkrim të vendimmarrjes së Gjykatës së Shkallës së Parë dhe parashtrimin të pretendimeve të ngritura në ankim nga pala paditëse [...].* Sipas raportit vlerësues, arsyetimi se ku është mbështetur Gjykata e Shkallës së Parë në vendimmarrje është paraqitur prej subjektit të rivlerësimit në mënyrë shumë të zgjeruar. Konstatimet e raportit vijoje duke vënë në dukje se mungon mendimi konkret i Ndhmësit ligjor (subjektit të rivlerësimit) për zgjidhjen e çështjes.

19.5 Nga shqyrtimi i dokumentit të tretë, *Relacion për çështjen administrative nr. ***/***/*** regj., datë ***.11.2014*, është konstatuar se ai paraqitet në formën e draftvendimit, nga shqyrtimi i të cilit rezulton se përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kushtetutës, Kodit të Punës, Kodit Civil, ligjit nr. 49/2012 etj. Sipas përfundimeve të raportit vlerësues, subjekti i rivlerësimit nuk ka përdorur në arsyetim parime të së drejtës, por referenca ligjore. Draftvendimi është nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit si konceptuese, por nuk pasqyron datën e përpilimit të tij.

19.6 *Pesë dokumente ligjore të përzgjedhura me short* janë çështje administrative, të cilat kanë përfunduar me vendim të Gjykatës Administrative të Apelit. Në raportin vlerësues, përfundimi i arritur për të pesë¹⁰ këto dokumente të përzgjedhur me short, pas shqyrtimit të dosjeve gjyqësore, referuar nenit 6¹¹ të ligjit nr. 49/2012, ka qenë se: [...] *a) nuk është përfshirë ndonjë akt, që të dokumentojë ndihmën dhe këshillimin, që Ndhmësja ligjore i ka dhënë gjykatës, lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtim gjyqësor; b) nuk është përfshirë përgatitja e ndonjë projekt-akti procedural të nevojshëm për gjykimin që të mbajë nënshkrimin në cilësinë e konceptuesit prej Ndhmëses ligjore; c) nuk është përfshirë ndonjë kërkesë nga gjykata drejtuar Ndhmëses ligjore për të bërë kërkime ligjore apo për të hartuar opinion me shkrim për*

¹⁰ (1) Çështje administrative me nr. ***/***/*** akti, datë ***.1.2015, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë ***.1.2017; (2) Çështje administrative me nr. ***/***/*** akti, datë ***.3.2015, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë ***.5.2017; (3) Çështje administrative me nr. ***/***/*** akti, datë ***.4.2015, e përfunduar me vendimin nr.***, datë ***.3.2018; (4) Çështje administrative me nr. ***/***/*** akti, datë ***.5.2015, e përfunduar me vendimin nr. ****, datë ***.9.2017; (5) Çështje administrative me nr. ***/***/*** akti, datë ***.5.2015, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë ***.9.2017.

¹¹ Neni 6, “*Ndhmësit ligjorë*” [...]1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit Administrativ, në veprimtarinë e tij ndihmohet nga Ndhmësi ligjor. 2. Ndhmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projekt-akte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të Gjyqtarit, Ndhmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinionone me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim [...].

problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjen në fjalë. Rrjedhimisht, në dosje nuk rezulton i administruar ndonjë akt kërkimi ligjor apo opinion me shkrim nga vetë Ndhmësja ligjore [...].

19.7 Nisur nga konstatimet e mësipërme në raportin vlerësues parashtrohet se, lidhur me treguesin e aftësisë profesionale, vlerësuar sipas nëntreguesve: (i) njohuritë ligjore dhe (ii) arsyetimi ligjor nuk mund të konfirmohet në 5 dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short. Për sa i përket treguesit aftësitë organizative, vlerësuar sipas nëntreguesve, aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, rendimenti nuk mund të përcaktohet, pasi kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde minimale, aftësia për të kryer procedurat gjyqësore – nuk mund të nxirret nga 5 dosjet e vëzhguara, referuar treguesit aftësia për të administruar dosjet - nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore nuk kanë datë përpilimi dhe janë nënshkruar vetëm në fund nga Ndhmësi ligjor, me rekuizitën: “konceptoi”. Për treguesin etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, vlerësuar sipas nëntreguesve etika në punë – referohet eksperiencia si juriste në shoqërinë “Hako” sh.p.k., dhe se nuk disponohen të dhëna nga burimet arkivore, për sa i takon treguesve: integriteti- nuk konstatohen të dhëna, paanësia - nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit, ndërsa në 5 dosjet e përzgjedhura nuk rezultojnë të administruara akte procedurale të hartuara nga subjekti i rivlerësimit. Për treguesin aftësia personale dhe angazhimi profesional, vlerësuar sipas nëntreguesve aftësia e komunikimit - nuk ka të dhëna për t’u vlerësuar, aftësia për të bashkëpunuar - nuk janë konstatuar të dhëna specifike, gatishmëria për t’u angazhuar - rezultojnë pjesëmarrje në trajnime në Shkollën e Magjistraturës.

19.8 Kryesisht, Komisioni, gjatë hetimit administrativ që kreu, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit, që krahas akteve të shqyrtuara nga organi ndihmës, KLGJ, t’i paraqesë ajo vetë Komisionit edhe disa dokumente ligjore të tjera (5-10 relacione), të përgatitura prej saj gjatë ushtrimit të detyrës.

19.9 Edhe pas depozitimit nga subjekti i rivlerësimit të 9 akteve/relacione të përgatitura prej saj, konstatimi i Komisionit lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezulton të ketë mbetur i pandryshuar dhe në përputhje me sa KLGJ-ja kishte konstatuar në aktin e hartuar në përputhje me ligjin (raportin vlerësues).

20. Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e datës 14.7.2022, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka paraqitur përgjigjet e saj lidhur me sa ka rezultuar nga hetimi administrativ, të cilat janë vlerësuar nga Komisioni dhe janë pjesë e vendimmarrjes së tij.

21. Komisioni, në rrethanat e parashtuara më lart, me vendimin e ndërmjetëm nr. 5, nr. 496 akti, datë 20.7.2022, me anë të cilit ka vendosur pezullimin me afat 1-vjeçar nga detyra të subjektit dhe detyrimin e ndjekjes së programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] dukshëm subjekti nuk ka reflektuar qartësi në arsyetim, madje në shumë raste, ai mungon tërësisht, çka krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit, në pozicionin e ndihmësit ligjor, nuk arriti nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, si në aspektin e njohurive të saj ligjore apo aftësive profesionale. Në materialet e përgatitura prej saj nuk janë identifikuar tregues të tillë, si: aftësia për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave apo aftësia për të analizuar jurisprudencën [...], si dhe [...] ka mangësi në arsyetimin ligjor dhe në aftësinë për

të përgatitur opinione të karakterit procedural apo edhe material për çështjet në gjykim. Evidentohen mangësi në rolin e saj si ndihmëse ligjore dhe në aftësinë për të përmbushur detyrat sipas përcaktimeve ligjore për pozicionin e ndihmësit ligjor [...], [...] eksperiencia e punës së znj. Jurida Bajraktari nuk ka qenë në harmoni me kërkesat ligjore që kërkojnë përvojë profesionale si jurist në: organet e sistemit të drejtësisë; funksione publike në administratën e Kuvendit; administratën e institucionit të Presidentit; aparatën e Këshillit të Ministrave; ministri dhe institucione qendrore të pavarura; Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë; Prokurorinë, si avokat apo si personel akademik i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës,¹² ndërsa në përfundim [...] duke çmuar në tërësi problematikat e konstatuara, vlerëson se ato janë të tilla që mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës [...].

22. Ndërsa, në vendimin përfundimtar të procesit të rivlerësimit, lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit: [...] Bazuar në rezultatet e arritura, të miratuara nga Këshilli Pedagogjik, si dhe Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. ***, datë 18.7.2023, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, është vlerësuar “mirë” në testimin përfundimtar, duke tejkaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Për sa rezultoi më sipër, trupi gjykses arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].

23. Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke mbajtur në konsideratë se besimi i publikut në sistemin e drejtësisë është pazgjdhshëmrisht i lidhur me efektivitetin, profesionalizmin dhe integritetin e treguar nga subjektet e rivlerësimit në ushtrimin e detyrës së tyre, çmon se, gjatë kontrollit të aftësive profesionale të subjektit znj. Jurida Bajraktari, ajo ka dështuar të ketë nivelin minimal kualifikues.

24. Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, sikundër u parashtrua më lart në këtë ankim, Komisioneri Publik vjen në përfundimin se veprimtaria profesionale e subjektit të rivlerësimit është, sikurse edhe organi përkatës i vlerësimit të aftësive profesionale ka konstatuar, pasqyrë e mungesës së evidentimit të treguesve të matshëm të aftësive profesionale në një sasi të konsiderueshme, çka përfaqëson një model pune të dobët, i cili nuk pajtohet me pozicionin e saj. Komisioneri Publik, në vlerësim të mangësive të vërejtura, vjen në përfundimin se ato, për shkak të vijueshmërisë dhe rëndësisë së tyre, nuk mund të korrigjohen përmes programit njëvjeçar të edukimit.

III/C. Gjetje në procedurën e punësimit

25. Subjekti i rivlerësimit ka filluar detyrën e Ndihmëses ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit, në datën ***.4.2016, referuar urdhrin me nr.*** prot., datë ***.4.2016, të Kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit. Rezulton se Ministria e Drejtësisë ka shpallur vende të lira të punës për pozicionin Ndihmësligjor në Gjykatën Administrative të Apelit.

¹² Referohuni faqes 13 të vendimit të Komisionit.

26. Në bazë të nenit 6/3, “Kushtet për emërim”, të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar (*ligj që miratohet me shumicë të cilësuar nga Kuvendi*), kandidatët që përzgjidheshin në detyrën e Ndhmësit ligjor në Gjykatën e Apelit duhet të plotësonin kushtet e përvojës në punë si vijon:

[...]“ç” të ketë përvojë profesionale si jurist në organet e sistemit të drejtësisë, në funksione publike në administratën e Kuvendit, administratën e institucionit të Presidentit, aparatit e Këshillit të Ministrave, ministri dhe institucione qendrore të pavarura, në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, në Prokurori, si avokat apo si personel akademik i Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës;...

(ii) Mbi 7 vjet përvojë pune për pozicionin e Ndhmësit ligjor në Gjykatën e Apelit [...].

27. Në referencë të shqyrtimit të kriterit të aftësive profesionale, Komisioni, me të drejtë, është ndaluar dhe ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, referuar të dhënave të regjistrave zyrtarë përkatës, në momentin e aplikimit rezulton se nuk e përmbushte këtë kriter ligjor, si për shkakun se eksperiencia e pretenduar e punës lidhej me punësimin më së shumti në entitete private (*shoqëri tregtare, shoqata sportive etj.*), por edhe se në tërësi përvoja e punës e dokumentuar ishte rreth 3 vite e gjysmë, përkundër përvojës prej 7 viteve të kërkuar nga ligji.

28. Në vijim të hetimit administrativ të Komisionit, lidhur me procedurën e emërimit të subjektit të rivlerësimit, përfundimet e arritura janë parashtruar në aktin “Rezultate të hetimit” dhe janë pasqyruar si në vendimin e ndërmjetëm nr. 5, nr. 496 akti, datë 20.7.2022, dhe në vendimin përfundimtar nr.701/2023, për konfirmimin e subjektit në detyrë.

29. Komisioni, si në vendimin e ndërmjetëm, ashtu edhe në vendimin përfundimtar, këtë procedurë të emërimit, edhe pse e ka gjetur në [...] *mospërmbushje në mënyrë kumulative të kriterit ligjor, e ka çmuar, mangësi, si pjesë e mungesës së duhur të formimit profesional dhe aftësive të saj për të identifikuar konfliktin e normave apo aftësinë për të analizuar jurisprudencën për të përgatitur opinione të karakterit procedural apo edhe material për çështjet në gjykim* [...], porse e ka konsideruar të tillë që mund të plotësohet nëpërmjet programit të trajnimit për Ndhmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës.

30. Komisioneri Publik vlerëson se mospërmbushja e kriterit ligjor në procedurën e punësimit, nuk mund të konsiderohet si e riparueshme nëpërmjet programit të trajnimit dhe se kjo situatë e gjen subjektin e rivlerësimit me sjellje jo të përshtatshme, përkundër sa kërkohet nga funksionari i sistemit të drejtësisë, në kushtet kur ka pranuar të ushtrojë një funksion brenda sistemit të drejtësisë, për të cilin nuk përmbushte dukshëm kriteret specifike të parashikuara nga ligji, qoftë lidhur me natyrën e përvojës profesionale të punës, qoftë me kohëzgjatjen në vite të kësaj përvoje profesionale, duke cenuar në këtë mënyrë etikën profesionale.

31. Referuar verifikimit të kushteve për të identifikuar cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, pas vlerësimit tërësor, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, të kriterit të kontrollit të aftësive profesionale, parë në harmoni ai dhe me gjetjet e tjera pjesë e këtij ankimi, Komisioneri Publik vjen në përfundimin se problematikat e konstatuara nga vlerësimi në tërësi i procedurave në rastin konkret, duket se kanë cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe, për këto shkaqe, subjekti i rivlerësimit duhet të konsiderohet i papërshtatshëm për vijueshmërinë e detyrës, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Kërkimi i ankimit

- 1.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk plotëson kriteret e konfirmimit në detyrë;
- 2.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;
- 3.** Në të tilla kushte, ku subjekti rezulton me mangësi dhe mospërbushje të kërkesave të parashikuara në aneksin e Kushtetutës dhe legjislacionin e posaçëm, për kriteret e procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik çmon se, nga vlerësimi tërësor i çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për subjektin konkret duhet të gjejë zbatim neni 61, pika 5 e këtij ligji;
- 4.** Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4 dhe nenit 61, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;
- 5.** Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:
 - Ndryshimin e vendimit nr. 701, datë 25.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA